



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2653/5 prot.

Datë 17.10.2025

V E N D I M
Nr. 1467/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur-mbi kufirin e lartë monetar me mjete elektronike - Marreveshje Kuader me 1 (një) operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 24 muaj.”, me Nr. REF-56846-07-31-2025, me objekt: “Blerje hekur (zgara, profile hekuri, plegma, rrjeta metalike, tel bari, llamarine, panel sanduic, ele)”, me fond limit 24 746 000 (njëzet e kater milion e shtatëqind e dyzete e gjashtë mijë) lekë pa TVSH ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 31.07.2025): 253 883.25 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre pikë njëzet e pesë) Euro, zhvilluar më datë 01.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK me Nipt J67902827A dhe adresë: Lagjja Bishanak, Rruga Skenderbeu, Zona Kadastrale 5532, Banese private , Pasuria nr. 1/1088, Kati I-rë, Fier

Autoriteti Kontraktor: Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier
Lagja “11 Janari”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlëra limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 01.08.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit *“Procedurë e hapur- mbi kufirin e lartë monetar me mjete elektronike -*

Marreveshje Kuader me 1 (një) operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 24 muaj.”, me Nr. REF-56846-07-31-2025, me objekt: “Blerje hekur (zgara, profile hekuri, plegma, rrjeta metalike, tel bari, llamarine, panel sanduic, ele)”, me fond limit 24 746 000 (njëzet e kater milion e shtatëqind e dyzete e gjashtë mijë) lekë pa TVSH ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 31.07.2025): **253 883.25** (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre pikë njëzet e pesë) Euro, zhvilluar më datë 01.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier.

II.2. Në datën 01.09.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 16.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. ERVIN LUZI PF	19 748 900 lekë	kualifikuar
2. “ZEQIRI” SHPK	15 627 000 lekë	s’kualifikuar
3. “M U R A TI” SHPK	15 780 000 lekë	kualifikuar
4. “Genti 001” SHPK	18 095 000 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 16.09.2025 operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“ Referuar Shtojcës 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1/b këkohet: “b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;”.

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ZEQIRI SHPK, me NUIS J67902827A, ka ngarkuar në SPE formularin e sigurimit të ofertës me nr. Serial 060020760058448, datë 01.09.2025, nga ATLANTIK, vlera e të cilës nuk është e njëjtë me vlerën e sigurimit të ofertës të kërkuar në DST”.

II.5. Në datën 23.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Në datën 26.09.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa e operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK me numër ankimimi elektronik elektronik A/2025/5861, datë 26.09.2025 dhe me Nr. 2653/2025 Prot., datë 26.09.2025 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

“ O.E.Zeqiri shpk mori pjese ne proceduren me objekt “Blerje hekur (zgara, profile hekuri, plegma, rrjeta metalike, tel bari, llamarine, panel sanduic, ele)” te zhvilluar nga Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, KVO ka konstatuar se sigurimi i ofertës, i lëshuar nga kompania e sigurimit “Atlantik” sh.a., paraqet një mospërputhje në vlerë, për shkak se në tekstin e garancisë është harruar të shënohet një zero, duke rezultuar një vlerë më të ulët se ajo e kërkuar në dokumentet e tenderit.

Ky gabim është qartësisht një gabim aritmetik/teknik njerëzor, i konfirmuar edhe nga vetë kompania e sigurimit, i cili nuk reflekton vlerën reale të garancisë së paguar dhe të lëshuar. Në përputhje me nenin 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, gabimet aritmetike të evidentuara gjatë shqyrtimit të ofertave duhen korrigjuar, pa cenuar përmbajtjen reale të ofertës. (Konkretisht gabimi është se është shkruar 49.492 lekë dhe duhej 494.920)

Me dt.04.09.2025 Kompania e sigurimit Atlantik sh a dergon per efekt te A.K. sigurimin e rregullt te ofertes i cili ka te njejtin nr. Serie dhe nr,reference si dhe nje Deklarate Zyrtare ku pranon lapsusin e bere nga ana e tyre dhe sqaron se vlera e sakte eshte ajo e kerkuar nga A.K..

Keto dy dokument (Deklarata zyrtare dhe Sigurimi i Ofertes)u dorezuan ne Ndermarrjen e Sherbimeve Publike Fier me dt.08.09.2025 me Nr.735 Prot.

Me dt.16.09.2025 doli ne SPE Vleresimi ku Operatori yne eshte skualifikuar per arsye se vlera e sigurimit te ofertes nuk eshte e njejte me ate te kerkuar ne DST . Pra dokumentat e dhena nga Kompania Atlantik sh.a nuk u moren parasysh..”

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 2653/1 prot., datë 29.09.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2653 prot, datë 26.09.2025.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 563/14 prot., datë 06.10.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 2563/2 prot., datë 06.10.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor vendimi K.SH.A.-së mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1 Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik e tij me arsyet për mosplotësimin e kriterëve për kualifikim si më poshtë vijnë:

“Referuar Shtojcës 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1/b këkohet: “b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;”.

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ZEQRIR SHPK, me NUIS J67902827A, ka ngarkuar në SPE formularin e sigurimit të ofertës me nr. Serial 060020760058448, datë 01.09.2025, nga ATLANTIK, vlera e të cilës nuk është e njëjtë me vlerën e sigurimit të ofertës të kërkuar në DST”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas Shtojcës 9;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4;**

III.1.2. Në shtojcën 3 “Formulari i Sigurimit të Ofertës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 4.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- *Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;*
- *Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;*
- *Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.*

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

III.1.3. Në Seksionin 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, pika 3.1 “Sigurimi i ofertës”, “Njoftimi i kontratës”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objektankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar mënyrën e paraqitjes, afatin dhe vlerën e sigurimit të ofertës, si më poshtë:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: *(e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se se prokurimi me vlerë të vogël). PO*

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **494 920 leke pa tvsh** (katërqind e nentëdhjetë e katër mijë e nentëqind e njezet) **lekë pa tvsh** (shuma e shprehur me fjalë).

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

3.1.2 Autoriteti/ enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor: Emri i Institucionit perfitues: Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier; Kodi i Institucionit: 2111006; Kodi i degës së Thesarit ku vepron: 0909; Kodi i llogarise ekonomike: 6020200 (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor).

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **X**

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 ditë (shprehur në ditë).

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë: -Formularin e Sigurimit të Ofertës me Nr. 060020760058448, në emër të shoqërisë “ZEQIRI” SHPK, të lëshuar më datë 01.09.2025, nga shoqëria e sigurimeve “ATLANTIK” SHPK për Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier, si kusht për sigurimin e ofertës së operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK për procedurën e prokurimit publik me Nr. REF-56846-07-31-2025, me objekt: “Blerje hekur (zgara, profile hekuri, plegma, rrjeta metalike, tel bari, llamarine, panel sanduic, ele)”, me vlerën 49,492.00 (dyzete e nente mijë e katerqinde e nentëdhjetë e dy) lekë, për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 150 ditë.

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.

III.1.6. Në neni 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës,

autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

III.1.7. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. *Autoriteti/enti kontraktor 57 duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.*”

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2.1.b të Shtojcës 8/2 të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor sipas parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, ka përcaktuar që ofertuesit të dorëzojnë në momentin e ofertimit, sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3 të këtyre dokumenteve, si dhe sipas përcaktimeve në pikat 3.1.3, 3.1.2 dhe 3.1.3 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike”, të Njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka përcaktuar format alternative të paraqitjes së sigurimit të ofertës, ku njëra është në formën e garancisë bankare ose tjetra nga një shoqëri e licencuar nga autoritetet kompetente, sikurse parashikohet dhe në nenin 83 të LPP-së, gjithashtu ka parashikuar edhe vlerën e sigurimit prej 494 920 *(katërqind e nentëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e njezet)* lekë, objektin e procedurës së prokurimit, numrin e referencës së kësaj të fundit si dhe afatin e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës për një periudhë prej 150 ditë.

III.1.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, nga operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Konkretisht, referuar “Formularit të Sigurimit të Ofertës” të dorëzuar nga operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK, konstatohet, se ky i fundit është lëshuar në njërën prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe konkretisht nga shoqëri të licencuara nga autoritetet

kompetente dhe përkatësisht shoqëria e sigurimit “ATLANTIK” SHPK, ku formulari i sigurimit të ofertës së lëshuar nga kjo shoqëri dhe përkatësisht formulari me Nr. 060020760058448, është sipas Shtojcës 3 të dokumenteve të tenderit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor, si dhe ky formular është sipas formës së përcaktuar dhe afatit të vlefshmërisë së kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikat 3.1.2, 3.1.3 dhe 3.2 të Seksioni 3: “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” të dokumenteve të tenderit, Por nga shqyrtimi i këtij formular sigurimi të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues Komisioni konstaton se, vlera e sigurimit të ofertës nuk është e njëjtë me vlerën e përcaktuar në DST. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se formulari i sigurimit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK, është lëshuar nga shoqëria e sigurimeve “ATLANTIK” SHPK më datë 01.09.2025, ku është përcaktuar se ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në njoftimin e kontratës që është 150 ditë, por jo në vlerën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor,. Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “ZEQIRI” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar nuk e ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.b të Shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit me të dhënat e sakta referuar proceurës aktuale në të cilën ka marrë pjesë si ofertues.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ZEQIRI” SHPK nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur- mbi kufirin e lartë monetar me mjete elektronike - Marreveshje Kuader me 1 (një) operator ekonomik – ku te gjitha kushtet jane te percaktuara – me afat 24 muaj.”, me Nr. REF-56846-07-31-2025, me objekt: “Blerje hekur (zgara, profile hekuri, plegma, rrjeta metalike, tel bari, llamarine, panel sanduic, ele)”, me fond limit 24 746 000 (njëzet e kater milion e shtatëqind e dyzete e gjashtë mijë) lekë pa TVSH ose fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 31.07.2025): 253 883.25 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre

pikë njëzet e pesë) Euro, zhvilluar më datë 01.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Fier.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “ZEQIRI” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

